



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:156244

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06481511

PPP.nr.166/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përmbartimore me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunatorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë, kundër debitorit H.H me adresë në rrugën "...", Komuna e..., lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej ... gjykata duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori me datë ..., kundër Urdhërit mbi lejimin e Përmbartimit, gjykata jashtë seancës gjyqësore me datën ..., nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit H.H nga Komuna e Mitrovicës, ushtruar kundër urdhërit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.... të datës ..., sipas propozimit të kreditorit KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë.
- II. Mbetet në fuqi Urdhëri Përmbartimor P.nr...të datës ..., i lejuar nga Përmbartuesi Privat, ... i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Arsyetim

Kreditori KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë, ka ushtruar propozimin për përmbartim të përmbartuesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimi ndaj debitorit H.H nga Komuna e .., si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 241.84 €, me kamatë ligjore 8 %, po ashtu edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimin dhe sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe pas bllokimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet e mbledhura të transferohen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbartim të datës

Përmbartuesi privat ... me urdhrin përmbartimit P.nr.... të datës ..., e ka lejuar propozimin për përmbartim në këtë çështje përmbartimore.

Debitori H.H me adresë në rrugën "...", Komuna e Mitrovicës, për shkak të shkeljeve të procedurave permbarimore, si dhe në kundërshtim me nenin 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kreditori ka paraqitur propozim për permbarim duke u bazuar në dokumentin e besueshëm, përkatësisht në faturën e cila përmban obligime të cilat janë parashkruar. Andaj i propozoj Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të refuzohet urdhëri permbarimor.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pabazuar për faktin se fillimisht kreditori propozimin për permbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm konform nenit 29, kurse sa i përket parashkrimit këtu s'kemi të bëjmë me parashkrim sepse është kërkuar borxhi për periudhën prej ... deri me ..., ku debitori i ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nga Kompania, por debitori ka dashur të i ikë përgjegjësive të tij dhe asnjëherë në kompani nuk kemi pranuar ankesë nga ana e debitorit se nuk janë duke i shkuar me rregull faturat për shpenzimet e ujësjellësit. Si provë përgjigjes ja bashkëngjisim ekstraktet e faturave ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe ka bërë pagesa të kohë pas kohshme, andaj konsideroj se propozimi i kreditorit duhet të përmbushet konform nenit 27 paragrafi 1 dhe 29 paragrafi 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Gjykata Themelore Mitrovicë, si permbarimorë në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit i cili kundërshton urdhërin për permbarim shkak të shkeljeve të procedurave permbarimore, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për permbarim e ka iniciuar në bazë të faturës, e sipas nenit 29 paragrafi 1.3 në lidhje me paragrafi 3 të LPP-së, fatura konsiderohet dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm për permbarim, po ashtu në shkresat e lëndës gjendet kartela financiare e konsumatorit dhe që nga data ... e deri në momentin e paraqitjes së propozimit për permbarim janë të specifikuar si data, numri, vendi, sasia e ujit të harxhuar, vlera në euro, pagesat eventuale si dhe borxhi i përgjithshëm.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se borxhi është parashkruar, gjykata gjeti se i njëjti nuk është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), ku parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin ..., afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me ..., kurse për vitin 2... nuk ka vjetërsim të borxhit-parashkrim, për faktin se kreditori, propozimin për permbarim e ka parashtruar me datën ..., me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për permbarim këtë fakt gjykata, e mbështetë në nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së i cili nen parasheh se "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij", ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se "Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak". Sa i përketë kamatës se aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 paragrafi 1.3 dhe paragrafi 3, 69, 71, 73 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e në lidhje me nenin 245 paragrafi 1 dhe 2, 360 paragrafi 1 dhe 2, 368, dhe neni 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.166/2023, datë 20.11.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.